



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 233/6 Prot

Tiranë, më 19.08.2025

V E N D I M
Nr. 44, datë 19.08.2025

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026 – 2028 NË
UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS”**

Bordi i Administrimit, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimin plotësues Nr.7, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, VKM Nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike”, Vendimin Nr. 31, datë 18.07.2025 të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. — Prot., datë 08.08.2025, në mbledhjen e tij të datës 19.08.2025,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm 2026 – 2028 të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Njësisë Kryesore të UBT-së, bashkëngjitur pasqyrat.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Donika KËRÇINI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Matilda SHABANI

Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci